



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovec / Municipality of Rahovec
KUVENDI I KOMUNËS / SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY

RAHOVEC / ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 1/23 Nr. ifaq./Br.str./No pa 62

Në bazë të nenit 12 pika 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17, nenit 24 dhe nenit 40 paragrafi 2 shkronja c) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), dispozitave të Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, Ligjit Nr. 08/L-016 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, dispozitave Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, Ligjit Nr. 05/L-108 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal dhe nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.3, nenit 57 dhe nenit 63 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 28.04.2023 miraton këtë:

V E N D I M

Për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2022 në vitin 2023

1. Miratohet vendimi për bartjen e mjeteve të pashpenzuara nga viti 2022 në vitin 2023 në shumë prej 421,721.58€ (katërqind e njëzet e një mijë e shtatëqind e njëzet e një euro e pesëdhjetë e tetë cent)
2. Mjetet në shumën prej 421,721.58€ (katërqind e njëzet e një mijë e shtatëqind e njëzet e një euro e pesëdhjetë e tetë cent) do të barten në vitin 2023 në këto programe dhe kategori buxhetore si në vijim:
 - Në kategorinë e investimeve kapitale në shumë prej 346,721.58 €:
 - 2.1. Në programin Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia (180), nën programi Infrastruktura Publike (18171), kodi funksional (0451).
 - 2.1.1 Ndërtimi rrugëve Rahovec-Xerxe-Opterushë-Krushë Madhe-Gexhe-Kramovik-Hoqë, kodi 53790 në shumë prej 50,000.00€;
 - 2.1.2. Ndërtimi rregullimi kanalizimeve fekale (Gropa Septike) Krushe e Madhe, Dejne, Ratkoc, Dobidol, Radoste, Rahovec, Xerxe, Gexhe, kodi 53866 në shumë prej 40,000.00€;
 - 2.1.3. Ndërt. i kan. për ujëra atmos. dhe ndërt. i rrugëve me kubëza në fshatin Zatriq, kodi 48181 në shumë prej 7,200.00€
 - 2.2 Në programin Planifikimi urban dhe mjedis (660), nën programin planifikimi urban dhe inspeksion (66360), kodi funksional (0620).
 - 2.2.1. Rregullimi shtreterve lumenjve prockave Krushe Madhe, Polluzhë, Radoste, Dejne Celin, Sapniq, kodi 53800 në shumën prej 100,000.00€.
 - 2.2.2. Rregullimi varrezave Dëshmorëve dhe Civileve Celinë-Krushë Madhe, Opterushë, Ratkoc-Mrasor, Rahovec kodi 53858 në shumën prej 20,000.00€;
 - 2.3 Në programin Kulturë, Rini, Sport (850), nën Shërbimet Kulturore – Rahovec (85011), kodi funksional (0820).
 - 2.3.1 Ndërtimi i Muzeut në Krushë të Madhe, kodi 50753 në shumën prej 22,921.58€;

2.3.2 Ndërtimi dhe rregullimi i Shtëpisë së kulturës Celinë (projekt i ri), në shumën prej 30,000.00€

2.4. Në programin Arsim dhe Shkencë (920), nën programin Arsimi parashkollor (92410), kodi funksional (0911)

2.4.1. Ndërtimi i qerndes ne Ratkoc, kodi 45787 në shumën prej 1,600.00€;

2.5 Në programin Arsim dhe Shkencë (920), nën programin Arsimi fillor, i mesëm i ulët (93300), kodi funksional (0912)

2.5.1. Ndërtimi i shkollës fillore në Fortesë, kodi 48090 në shumën prej 45,000.00€;

2.5.2. Renovimet në shkollat Rahovec, Qifllak, Zoqishtë, kodi 53783 në shumë prej 30,000.00€

- Në kategorinë e Mallërave dhe Shërbimeve në shumë prej 75,000.00 €:

2.6 Në programin Planifikimi urban dhe mjedis (660), nën Programin Planifikimi Urban dhe Inspeksion (66360), kodi funksional (0620). Në shumë prej 75,000.00€

3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-në dhe 7 ditë pas shpalljes publike në ueb-faqen e Komunës së Rahovecit.

Vendimi u dërgohet:

- *Kryetarit të Komunës,*
- *Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01 Nr.62/22
Datë: 28.04.2023

